



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 2985/6 Prot.

Vlorë më, 20.11.2025

VENDIM

Nr. 106, datë 20.11.2025

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 89, DATË 20.11.2024 "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË PERSONELIT NDIHMËSAKADEMIK DHE ADMINISTRATIV" DHE VENDIMIT TË SENATIT AKADEMIK NR. 14 DATË 24.02.2025 "PËR DISA NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE, NUMERIKE DHE ORGANIGRAMËN E UNIVERSITETIT 'ISMAIL QEMALI' VLORE.

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, gërma ç dhe nenit 3 pika 4, gërma ç të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenit 19, pika 1, gërma ç të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 22 të Rregullores së Brendshme të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë ; të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 27, datë 29.12.2017, "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë" referuar propozimit me nr.2417/1 prot., datë, 13.10.2025; Senati Akademik në mbledhjen e datës, 20.11.2025,

VENDOSI:

1. Struktura e Drejtorisë së Shërbimeve Administrative në Universitetin 'Ismail Qemali', Vlorë në nivel institucional, të miratuar në Vendimin 89, datë 20.11.2024 të Senatit Akademik, të shtohet me një personel, staf pastrues pranë Sektorit të Shërbimeve.
 2. Numri i përgjithshëm i personelit ndihmës-akademik dhe administrativ ndryshon duke u rritur me 1 (një) personel dhe në total shkon 124 (njëqind e njëzetë e katër) personel ndihmësakademik dhe administrativ.
 3. Ky vendim propozohet për miratim përfundimtar në Bordin e Administrimit.
- Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i Administrimit të UV-së.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. Aurela Saliaj

